



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-26355/23 datë: 26.09.2023



Npi – 01/344 datë: 28.09.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 28.09.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -IX- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 28.09.2023 (e enjte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Praktikantët znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.08.2023,
2. Diskutim për rexhistrimin e nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme nga Komuniteti pakic,
3. Funksionimi i Qendrave Mësimore për Komunitetet,
4. Diskutim për parandalimin e braktisjes së mësimin nga nxënësit e komuniteteve,
5. Plani Buxhetor Komunal 2024-2026 (Pas diskutimit publik).
6. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, për sa i përket pikave të rendit të ditës po dakordohemi, sepse kemi lavdatë për Kryesuesin që po konsulltohet me neve si anëtarë të Komitetit. Mos prezenca e drejtorëve tregon një joseriozitet, jam i dëshpëruar me këtë neglizhencë. Nuk e di për çka do të diskutojmë këtu kur nuk e kemi drejtoreshën. Përgjegjësia është e atyre që po na sjellin në dështimin e Komitetit e që janë pikërisht drejtorët. Unë mendoj që nuk kemi çka diskutojmë përveç pikës të ndryshme.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, pajtohem me Besnikun se është e padrejtë që nuk po marrin pjesë drejtorët, për pikën e tretë unë mendoj se mundemi të diskutojmë sepse Muhameti është ai që punon në këtë program.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Edhe unë jam i kyqur në këtë program për sa i përket qendrave mësimore.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, është për keqardhje që drejtorat nuk marrin pjesë përveç Bardhylit e Bujarit, edhe pse ne u kemi dërguar rekomandime. Nuk kemi shumë informata për nxënës. Edhe unë mendoj se ne mundemi me diskutu për pikën e tretë, e për të tjerat nuk kemi çka me diskutu.

z.Arton Demiri; Përsëritet, ju bashkangjitem kolegëve që nuk kemi qka të diskutojmë, sepse unë kam përvorje të keqe që nuk ma kanë pranuar qikën time në çerdhe, dhe nuk ka ndonjë arsyetim.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Mendoj se për pikën e parë dhe të tretë mund të diskutojmë, për pikën e pestë dhe të gjashtë me i shty.

znj.Rrezartë Ramadani; Unë jam që të vazhdojmë me këto pika 1,3,5,6 ndërsa për pikën 2 dhe 4 me i dërgu një Email drejtoreshës së arsimit për me marrë pjesë në mbledhje.

z.Besnik Seferi; Unë pajtohem që pika 5 të mos diskutohet fare, sepse nuk e kemi planin buxhetor as për Kuvend, prandaj mendoj se është kështu që pikat 2,4,5 të mos shqyrtohen fare.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për pikat 2 dhe 4 të dërgohet Email te drejtoresha arsimit. Ndërsa pika 5 të mos diskutohet fare.

***Komiteti për Komunitete, unanimitet miratoi rendin e ditës ashtu që për pikat 2 dhe 4 të dërgohet një E-mail për sqarim te drejtoresha e arsimit, ndërsa pika 5 të mos diskutohet fare, sipas kësaj renditje:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.08.2023,
2. Funksionimi i Qendrave Mësimore për Komunitetet,
3. Të ndryshme.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.08.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Unë kam një kërkesë për përmirësimin e fjalëve: "Javën e kaluar" të përmirësohet me fjalët "Seancën e kaluar".

***Komiteti për Komunitete, unanimitet miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më: 29.08.2023 me vërejtjen e znj.Rrezartë Ramadani.**

Pika 2

Funksionimi i Qendrave Mësimore për Komunitetet

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Sa i përket kësaj qendre që organizohet nga OJQ "Ballkan Sunflower" është për lavdatë sepse e kryejn një punë të madhe të Komunitetit, sa i përket braktisjes të mësim nxënjes. Gjithsej kemi 66 nxënës të rexhistruar nga klasat 1-5. Prej tyre 61 janë nga Komiteti Ashkali, 1 nga Komiteti Romë, 4 Shqiptarë. Kemi pasë kërkesa të shumta, mirëpo për arsye buxhetore nuk ka pas mundësi me u pranuar të gjithë. Pritet që Qeveria ti lëshon 2 milion euro për qendrat mësimore. Është për keqardhje pse nuk funksionon në Muzeqinë. Fëmijët janë furnizuar me libra, dhe gjithçka po shkon mirë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për këto qendra mësimore, Komuna është dashur të bëjë një zgjidhje dhe rregulloren e Qeverisë për procedurat e përzgjedhjes së drejtorave e strukturave tjera duhet të miratohet në këtë rregullore ku parashihet edhe tutori.

z.Besnik Seferi; Unë kisha kërku që drejtoresha ti kushtojë pak më shumë rëndësi kësaj çështje dhe pyetja është pse nuk janë shpenzuar këto mjete që kanë tepruar?

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne ja kemi lënë Komunës këtë buxhet që janë dikund 1 deri 3 mijë euro dhe këto mjete nuk i pranojmë mbrapa.

Pika 3

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Afër 5 muaj shefi i zyrës për komunitete ka dal në pension e ne nuk e dimë se qka po ndodhë me atë zyre. Janë 8 mijë euro që duhet të shpenzohen. Për këtë vit, janë edhe mbi 2 mijë euro.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne kemi tentuar me pas një takim me kabinetin e Kryetarit ku ka qenë një konkurs i brendshëm. Anëtarët e Komitetit për Komunitete jemi për me i dhënë sygjërimet për Komunitetin pakicë dhe nevojave të qytetarëve. IOM-i është një organizatë joqeveritare që investon 20 mijë euro ose më shumë në vitë e nuk është mirë me i hup këto donacione.

z.Muhamet Mehmeti; Kjo OJQ IOM-i bënë thirrje për me apliku ç'do 4 vite. Shuma e përgjithëshme ka qenë 4 mijë euro, që kanë përfituar 5 qytetarë. Unë jamë përfaqësues (bashkëpunëtor) i zyrës së IOM-it për Komunën e Shtimes.

z.Besnik Seferi; Qështjen e zyrtarit të zyrës që është në mungesë, shumë njerëz më drejtohen se e kanë kuptuar që jamë anëtarë i Komitetit për Komunitete. Mendoj se duhet me bërë një hap më të madh për këtë çështje. IOM-i kanë bërë shumë projekte nëpër gjithë Kosovën, është komplet papërgjegjësi për me i humb donacionet. Duhet të jepet rëndësi kësaj qështje edhe në Kuvend duhet ta ngrisim.

z.Muhamet Mehmeti; Kemi problem edhe me 4 fëmijë që nuk ju paguhet qeraja e tyre.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Nëse nuk ka diskutime të tjera ju falenderojë për prezencën. Jemi mjaft bashkëpunues si anëtarë të Komitetit. Edhe për sekretarin e Kuvendit falemnderim.

Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:08h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi